

# DeckPrepare



TRAJTIMI PARA



## "Anti-Aging" për verandën tuaj të diellit: mbështetje efektive për trajtimin mbrojtës fundor

Lyerje speciale për dorën e parë për dysheme prej druri në ambient të jashtëm. Vendosi e thjeshtë, veprim i dyfishtë: DeckPrepare përforcon në mënyrë efektive mbrojtjen dhe ngjitjen e dorës së fundit pasuese të sipërfaqes me LOBA DeckOil / Color ose LOBA DeckFinish Color. Nëpërmjet stabilizimit të fuqishëm të substancave përbërëse të vetë drurit, DeckPrepare ngadalëson marrjen e ngjyrës gri nga ana e drurit.

- Ngadalëson marrjen e ngjyrës gri nga ana e drurit për shkak të kushteve të mjedisit
- Përforcon veprimin mbrojtës të përpunimit përfundimtar pasues të sipërfaqes
- Përmirëson ngjitjen e shtresës pasuese me shtresën e poshtme
- Përpunimi i shpejtë dhe i sigurt
- Thahet shpejt
- Pa ngjyrë dhe pa aromë
- Jo i dëmshëm për mjedisin
- I përdorshëm në sistem me LOBA DeckFinish Color. Mund të përdoret në mënyrë opsionale para imprenjimit me LOBA DeckOil / Color

### Gama e përdorimit:

Të përshtatshme për deck druri, mobilje kopshti dhe objekte të tjera prej druri në ambientet e jashtme.

## Të dhëna teknike të produkteve

NR. ARTIKULLI			
11841	5l	4	128

<b>Solide</b>	16,4 ±2%
<b>Viskoziteti</b>	11 ±2s
<b>Magazinimi dhe transportimi</b>	12 muaj kohëzgjatja maksimale e magazinimit. Material i parrezikshëm sipas ADR. Depozitim dhe transportim në temperatura +5°C deri +25°C. Mbrojeni nga ngrica.
<b>GISCODE</b>	W2+
<b>2004/42/CE</b>	Vlera e lejueshme i BE-së për produktin (Kat. A/i): 140g/l (2010). Ky produkt përmban maksimumi 2g/l VOC.

## Udhëzime përpunimi

- Kushti optimal i përpunimit në +15°C deri +25°C, lagështia relative e ajrit 40% deri 75%, temperatura e materialit +15°C deri +25°C.
- Mos e vendosni mbi pjesët e nxehta ose mbi sipërfaqet e ekspozuara kundrejt rrezeve të diellit, duke qenë se shtresa e vendosur mund të thahet shumë shpejt. Mos e vendosni, nëse brenda 3 orëve pas vendosjes pritet të bjerë shi.
- Nëse keni dyshimi, krijoni një sipërfaqe testimi për të përcaktuar përputhshmërinë, ngjitjen dhe optikën. Rezultatet mund të ndryshojnë në varësi të llojit të drurit, sidomos në rastin e llojeve të druve që përmbajnë vaj, me ngjyra intensive dhe rrëshirë.
- Tundni mirë materialin.
- Para aplikimit transferoni materialin në një kovë LOBATOOL.
- Mënjanoni formimin e bulëzave mbi sipërfaqe, ose sheshojeni menjëherë me penel ose furçë.
- Kini parasysh rregullat e përgjithshme dhe specifike të sigurisë së punës për produktin. Me shumë informacion specifik në lidhje me GISCODE mund të gjendet tek udhëzimet e përdorimit, të disponueshme në [www.wingis-online.de](http://www.wingis-online.de).

### HOLLUES

Produkti është gati për përpunim dhe nuk lejohet hollimi!

### MJET APLIKIMI / NORMË APLIKIMI

Furçë vaji LOBATOOL, penel / 100-120ml/m<sup>2</sup>. Konsumi faktik i materialit mund të ndryshojë në varësi të llojit të drurit, të lagështisë së drurit dhe të gjendjes së ekspozimit kundrejt motit të sipërfaqeve. Në rastin e sipërfaqeve që janë ekspozuar shumë kundrejt motit duhet të llogarisni me një konsum shumë më të lartë të materialit.

### KOHA E THARJES

- Tharje për 1 orë. Prisni tharjen e plotë

### SISTEMET E KËSHILLUARA PËR TRAJTIMIN E MËVONSHËM

- LOBA DeckOil & DeckOil Color
- LOBA DeckFinish Color

### PËRGATITJA:

Trajtimin paraprak optimal të sipërfaqes mund ta shihni tek informacionet teknike të LOBA DeckDegrayer.

### PËRPUNIMI:

- Sipërfaqja duhet që direkt para aplikimit të jetë e thatë.
- Vendosni një shtresë LOBA DeckPrepare.
- Tharje për 1 orë. Prisni tharjen e plotë
- Më pas vendosni LOBA DeckOil / Color ose LOBA DeckFinish Color në përputhje me informacionin teknik.
- Për një ruajtjen të vazhdueshme të vlerave optike, ne rekomandojmë një pastrim themelor vjetor dhe një shtresëzim të ri të dyshemesë së verandës.

### INFORMACION I RËNDËSISHËM

Te llojet e druve me ngjyrë intensive me LOBA DeckOil (veçanërisht transparent) duhet të kihet kujdes që të bëhet një aplikim i njëtrajtshëm. Vendosni materialin në drejtim të fibrës për çdo dërrasë dhe evitoni zonat e mbivendosura, këto mund të dalin në pah.

## Udhëzime të përgjithshme

**Koha e tharjes:** Kohët e dhëna të tharjes vlejën në +20°C dhe në 50% lagështirë ajri relative. Temperaturat më të ulëta, lagështia relative më e lartë e ajrit shkakton vonesa të tharjes. Para arritjes së fortësisë finale mos pastroni me leckë të lagur. Karakteristikat specifike të produktit gjenden në informacionet teknike përkatëse.

### Përdorimi i LOBA DeckFinish Color në montimin e plotë:

Parimisht LOBA DeckFinish Color mund të përdoret pa LOBA DeckPrepare. Përdorimi i LOBA DeckPrepare përmirëson shumë karakteristikat e ngjitjes së llakut kundrejt dyshemesë dhe rrit sigurinë e përpunimit.

Informacioni në këtë material si dhe të gjitha këshillat dhe rekomandimet, të cilat ofrojmë në ndihmë dhe asistencë të përdoruesit, janë rezultat i përvojës së deritanishme dhe u referohen kushteve Speciale. Për shkak të mundësive të shumta të aplikimit dhe kushteve të përpunimit, nuk përjashtojmë nevojën e përdoruesit për të kryer testimet e veta ose të kërkojë këshilla teknike duke kontaktuar me Departamentin e aplikimit teknik LOBA. Respektoni standartet aktuale dhe rekomandimet e prodhuesit të produkteve për shtrimin-përpunimin e parketeve. Detyrimet dhe përgjegjësia janë përcaktuar ekskluzivisht nga Termat dhe Kushtet tona dhe nuk zgjerohen as përmes këtij informacioni as përmes këshillave tona. Publikimi i të dhënave më të reja teknike automatikisht zhvlerëson ato të mëparshme.

Fjalët dhe simbolet me shenjën © përfaqësojnë të drejta tregu, të cilat janë të regjistruara dhe të mbrojtura të paktën për hapësirën e Gjermanisë.